



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2022:275533

Datë: 29.05.2024

Numri i dokumentit: 05748255

**C-III-15-0704**

Paditësi: Z K, të cilin e përfaqëson avokati J B, Lipjan.  
Kundër

E paditur: NSH KB „Kosova”, përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit ( AKP ) në Prishtinë, rr. “Driton Hoxha ” nr. 55.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Specializuar, i përberë nga Gjyqtari Kryesues Hasim Sogojeva dhe Gjyqtaret anëtar Murat Hulaj dhe Manushe Karaqi, me 24 maj 2024, mori këtë :

**A K T V E N D I M**

**Konsiderohet e Tërhequr, Padia e paditësit Z K me të cilën ka kërkuar vërtetimin e pronësisë në pjesën e ngastrës kadastrale nr..., vendi i quajtur “S”, me sip 00.90,00 ha, ZK R i V.**

**Rrethanat Faktike dhe Procedurale**

Me 23.10.2015, paditësi përmes avokatit J B në DHPGJS, ka parashtruar padi për vërtetim pronësie në pjesën e ngastrës kadastrale nr..., vendi i quajtur “S”, me sip 00.90,00 ha, ZK R i V. Me padi ka theksuar, se paraardhësit i paditësit Xhemajl Kelmendi me Kuvendin Komunal në Lipjan, gjoja ka arritur pajtim gjyqësor që kjo parcelë të i kaloj në pronësi të Kuvendit Komunal Lipjan. Paditësi pretendon se këtë pajtim gjyqësor paraardhësi i tij nuk e ka nënshkruar asnjëherë, krejt kjo është bërë nga makinacioni i pushtetit dhe gjyqësisë së atëhershme, ku dhe ishte kërcënuar se në rast se do të ndërmer veprime kundër pajtimit gjyqësor do të ndëshkohet. Në vitet e 90-ta, paditësi së bashku me vëllain e tij ishin interesuar për këtë ngastër dhe kishin kuptuar se kjo ngastër i është bashkuar ngastrës nr..., dhe evidentohet në emër të Kooperativës Bujqësore “Kosova” në Lipjan.

Në vitin 1994, paditësi deklaroi se ka ushtruar padi në Gjykatën Komunale në Lipjan, e cila mban numrin C.nr.203/94, me të cilën kishte kërkuar që të anulohet pajtimi gjyqësor me numër C.nr.270/57, dt. 23.07.1957, me të cilin është aprovuar pjesërisht kërkesë padia duke e anuluar Pajtimin Gjyqësor, ndërsa pjesën tjetër e kishte refuzuar si të pabazuar, me pretendimin se e

paditura Kooperativa Bujqësore, e ka fituar të drejtën e pronësisë mbi bazën e vjetërsimit (parashkrimin fitues).

Paditësi deklaron se, paraardhësi i tij por edhe vet ai, asnjëherë nuk ishin zhveshur nga posedimi faktik, i kësaj sipërfaqe prej 9000 m<sup>2</sup>, të ngastrës nr. ..., arë, klasa IV, vendi i quajtur "S", ZK R i V.

Paditësi ka deklaruar se ka ushtruar padi në Gjykatën Komunale në Lipjan, e cila me Aktvendimin C.nr.317/05 dt. 10.04.2006, e ka Hedhë poshtë kërkesëpadinë me arsyetimin se çështja ishte e gjykuar.

Padisë si prova i ka bashkëngjitur:

- *Kopjen e Pajtimin Gjyqësore C.nr.270/57.*
- *Kopjen e Aktvendimit C.nr.317/05.*
- *Kopjen e Aktgjykimit C.nr.203/94.*

Më 23.11.2015 AKP- ja, ka parashtruar Mbrojtjen në Padi, me të cilën ka kundërshtuar padinë si të pa bazuar në ligj, duke deklaruar se paditësi nuk ka ofruar prova që vërtetojnë legjitimitetin e paditësit në procedurë. Ka theksuar nuk ka dëshmuar bazën ligjore me të cilën e mbështet kërkesë padinë. AKP po ashtu ka pohuar se, NSH është pronare ligjore e ngastrës kadastrale në kontest, pas që me aktgjykimin P.br.203/94 të dt. 21.01.1997, pik III e dispozitivit, ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, për kthim në posedim të pronës kontestuese. Dhe në bazë të këtyre fakteve AKP-ja konstaton se kjo çështje është e gjykuar. Kërkon nga Gjykata që ta Hedh poshtë si të papranueshme, ose ta refuzon si të pa bazuar në ligj padinë e paditësit.

Më 10.12.2021, DHPGJS ka lëshuar urdhër C-III-15-0704, me të cilën ka urdhëruar përfaqësuesin e paditësit, të jep përgjigje në mbrojtjen e të paditurës, dhe po ashtu të bëjë pagesën e taksës gjyqësore në shumën 100€ . Paditësi është njoftuar për pasojën juridike të mos veprimin.

Më 14.12.2021, Urdhri për pagesën e taksës gjyqësore përmes Postes është pranuar nga avokati J B përmes dorëzimit postar .

### **Arsyetimi ligjor**

**Padia e paditësit, konsiderohet e tërhequr.**

**Paditësi nuk e ka paguar taksën gjyqësore .**

Bazuar në nenin 5.5.2 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2017, hyrë në fuqi më 01 maj 2017, për aplikimin e njëjtë të taksave gjyqësore, paditëses i kërkohet që brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga të shërbyerit dhe pranimit i urdhrit të gjykatës për të ia dorëzuar Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës vërtetimin dhe faturën e pagesës të shumës së caktuar që duhet paguar ose që t'i dorëzojë gjykatës prova në lidhje me faktin se ai është i liruar nga pagesa për arsye se është përfitues i ndihmës sociale nga ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ose Ndihmës Ligjore nga Zyra për Ndihmë Juridike.

Udhëzimi Administrativ nr. 01/2017, për unifikimin e tarifave gjyqësore, neni 5 paragrafi 5.1, parashikon detyrimin e të gjithë atyre që i drejtohen Gjykatës për të paguar taksat gjyqësore për procedimin në shumën e duhur, ashtu që sipas neni 13 të Udhëzimit Administrativë nr. 01/2017, për unifikimin e taksave gjyqësore është caktuar taksa në lartësi 100 €.

Për më tepër, Udhëzimi Administrativ nr. 01/2017, neni 5.5.2 parasheh që, "nëse pas njoftimit, pala nuk i paguan taksat gjyqësore, sipas nenit 5.1 të këtij udhëzimi, gjyqtari i caktuar për çështjen, do të aplikojë nenin 253, paragrafi 5 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore dhe si pasojë padia do të konsiderohet e tërhequr.

Paditësi / avokati përmes Urdhrit, dt. 10.12.2021, u informua për faktin se në bazë të nenit të lartpërmendur të LPK-së, në rast të mos pagesës së taksës, Gjykata do të marrë një vendim duke e konsideruar të tërhequr ankesën.

Meqenëse paditësi, nga dita e pranimit të urdhrit dt. 10.12.2021 deri në ditën e marrjes së vendimit nuk e ka dorëzuar dëshminë për pagesën e taksës gjyqësore, gjykata në kuptim të dispozitës së nenit 253. 5 të LPK-së, ankesën/ kërkesën e paditësit e konsideroi të tërhequr.

### **Këshillë Juridike:**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrahet ankesë, me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh, nga pranimi i këtij aktvendimi.

Hasim Sogojeva, Gjyqtar kryesuese

Murat Hulaj, Gjyqtar anëtar

Manushe Karaqi, Gjyqtare anëtare